



Nr. ____ prot.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
GUVERNATORI

Tiranë, më 23.05.2024

VENDIM

Nr. 2302, datë 23.05.2024

PËR

REVOKIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT FINANCIAR JOBANKË “MICRO CREDIT ALBANIA” SH.P.K.

Sot më datë 23.05.2024, u njoha me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, përcjellë me shkresën me nr.3623, datë 23.05.2024, me objekt “Revokimin e licencës së subjektit financiar jobankë “MICRO CREDIT ALBANIA” sh.p.k.”. Nga shqyrtimi i relacionit, si dhe të analizës së bërë për propozimin, duke vlerësuar të gjitha shkaqet e përmendura aty,

VËREJ:

Subjekti financiar jobankë “MICRO CREDIT ALBANIA” sh.p.k. është licencuar për kryerjen e të gjitha formave të kredidhënies dhe shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për veprimtarinë e kredidhënies, sipas licencës së dhënë nga Banka e Shqipërisë me nr. 38, datë 09.05.2016, pezulluar me vendimin nr.644, datë 06.02.2024.

Në bazë dhe për zbatim të rregullores nr. 01, datë 17.01.2013 “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”, e ndryshuar, neni 10, pika 1, shkronja “a”, një nga kriteret që duhet të plotësojnë në vazhdimësi subjektet financiare jobanka gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, është që themeluesit e subjektit të kenë reputacion të mirë.

Bazuar në informacionin e marrë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me shkresën me nr. prot. 12287/1, datë 23.05.2024, jemi vënë në dijeni të faktit se ndaj ortakut të vetëm të subjektit financiar jobankë “MICRO CREDIT ALBANIA” sh.p.k., Elda Ibro, është vendosur masa e sigurimit personal “arrest në shtëpi” nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Mbështetur në sa më sipër, Departamenti i Mbikëqyrjes vlerëson se jemi në kushtet e parashikuara në nenin 14, pika 1, shkronja “h”, të rregullores së mësipërme, cit.: “.... Banka e Shqipërisë mund të pezullojë ose revokojë licencën e subjektit financiar jobankë, në rast se nuk

përmbush më kushtet në bazë të të cilave ai është licencuar”, dhe propozon revokimin e licencës së subjektit “MICRO CREDIT ALBANIA” sh.p.k.

Në përfundim, duke vlerësuar se propozimi i Departamentit të Mbikëqyrjes është i argumentuar, bazuar në nenin 14, pika 1, shkronja “h” të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”, miratuar me vendimin nr. 01, datë 17.01.2013 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, si dhe të shtojcës nr.3, pika 4 të rregullores “Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.36, datë 26.05.2010, i ndryshuar;

VENDOSA:

1. Revokimin e licencës së aktivitetit të shoqërisë “MICRO CREDIT ALBANIA” sh.p.k. për kryerjen e të gjitha formave të kredidhënies dhe shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për veprimtarinë e kredidhënies.
2. Shoqëria “MICRO CREDIT ALBANIA” sh.p.k. ka të drejtë të paraqesë ankim pranë Guvernatorit brenda 15 ditëve sipas parashikimeve të nenit 93 të Ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

GUVERNATOR

Gent Sejko

